



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN




|             |                                                   |
|-------------|---------------------------------------------------|
| Data        | 21.01.2026                                        |
| Referencë:  |                                                   |
| Për:        | Xhevat Bozhdaraj, Udhëheqës i Sektorit të Arsimit |
| Kopje / CC: |                                                   |
| Përmes:     |                                                   |
| Nga:        | Besnik Hulaj, drejtor i DKA-së                    |
| Tema:       | Plani vjetor i punës për vitin 2026               |

## DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM NË DEÇAN

### PLANI I PUNËS Për vitin 2026

Janar 2026



## **Përmbajtja e planit të punës njëvjeçare**

|                                                                                                                                     |       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Plani i punës -----                                                                                                                 | 3     |
| Vizioni -----                                                                                                                       | 3     |
| Misioni-----                                                                                                                        | 3     |
| Qëllimet e përgjithshme -----                                                                                                       | 4     |
| Buxheti i Drejtorisë për Arsim për vitin 2026 -----                                                                                 | 5-6   |
| Plani i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2025/2026 -----                                                  | 7-8   |
| Plani i punës për përgatitjen e lokaleve shkollore për vitin shkollor 2025/2026 -----                                               | 9     |
| Plani i punës që ka të bëjë me procesin edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2025/2026 .....                                      | 10-11 |
| Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-s me Kryetarin e Komunës, MASHTI-in, drejtorët e drejtorive, komunat tjera dhe me qytetarët ----- | 12    |
| Bashkëpunimi i DKA-s me organet e sigurisë Policinë dhe KFOR-in, OJQ-të dhe mediat-----                                             | 12    |
| Bashkëpunimi me përfaqësuesit e K. Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me Integrimet evropiane -----            | 13    |

## **Plani i punës**

Plani i punës është udhëzues për organizimin e punës dhe veprimin njëvjeçar të Sektorit të Arsimit, duke u mbështetur në faktorët shumë dimensional, e në veçanti në faktorët kryesor që paraqesin themelin e punës në Drejtorinë e Arsimit. Po ashtu plani i punës përbëhet prej disa elementeve kryesore të cilat janë të rëndësishme në ndërtimin dhe koherencën e tij, si:

- Vizioni
- Misioni
- Qëllimi.

## **Vizioni**

Sektori i Arsimit synon që arsimi në Komunën e Deçanit të zhvillohet në një ambient sa më të sigurt, modern dhe demokratik nga personeli i kualifikuar dhe i aftësuar në vazhdimësi, me përgjegjësi në punë dhe me një përfshirje cilësore të palëve të interesit. Të ofroj arsimim gjithëpërfshirës për përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme të nxënësve, iniciativën ndërmarrëse dhe pavarësinë e individit në shoqëri që të përballlet me sukses ndaj ndryshimeve të shpejta e të gjithmbarshme në mjedisin ku jetojmë.

## **Misioni**

Sektori i Arsimit do të angazhohet për të siguruar arsimim sa më cilësor, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha grupmoshat e nxënësve në mënyrë që individit të shfrytëzojë tërë aftësinë e vet në përparimin (ngritjen) e cilësisë si në mësimdhënie ashtu edhe në mësimnxënie duke zbatuar teknikat, metodat dhe strategjitë më bashkëkohore të punës në këtë sferë, duke synuar që:

- Çdo nxënës pa asnjë dallim t'i sigurohet nxënie cilësore e diturisë.
- Secili nxënës të shkollohet dhe arsimohet në mjedisin më të afërt, duke ju përshtatur nevojave të tyre sociale, fizike, kulturore dhe emocionale, gjithëmonë duke shfrytëzuar të gjitha potencialet intelektuale, profesionale që kemi, në mënyrë që nxënësve t'u sigurohet arsim cilësor
- Shkollat të afrojnë mjedis të shëndetshëm, tërheqës dhe miqësor, mësimdhënie më cilësore, në mënyrë që këto mjedise të jenë më të sigurta dhe më funksionale në misionin që kanë.
- Programet në SHFMU dhe të mesme të larta në bashkëpunim me MASHTI-n të sigurojnë përgatitjen e nxënësve që të mendojnë dhe punojnë në mënyrë kreative në zgjidhjen e të gjitha problemeve.
- Të zhvillojnë shkathtësitë duke ju përgjigjur nevojave me sukses dhe sfidave të jetës së Përditshme, shkollimit të mëtejshëm në përvetësimin e përhershëm të mësimi me moton "Mësimi gjatë gjithë jetës".
- Shkollat të jenë të hapura, ku prindërit do të kenë mundësi të kyçjes në vendimet të cilat kanë të bëjnë me fëmijët e tyre.
- Mësimdhënësit do të aftësohen në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e metodave të ndryshme bashkëkohore në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

## Qëllimet e përgjithshme

- Për periudhën njëvjeçare Sektori i Arsimit synon arritjen e rezultateve të përgjithshme, si:
- Sigurimi i hapësirës së nevojshme shkollore.
- Sigurimi i arsimimit për të gjithë.

-Arritja e rezultateve të përhershme në shkollimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe shkolla të mesme të larta në përputhje me kurrikulën për arsim që janë duke u bërë në mënyrë permanente nga MASHT-i.

- Inkurajimi i prindërve dhe i shoqërisë së gjerë në mbështetjen e arsimit dhe arsimimit të përgjithshëm;
- Shkallë të lartë të respektimit të ligjshmërisë në sferën e arsimit.

-Perfeksionimi i mëtutjeshëm i sektorëve të DKA-së në pajtim me ligjin dhe udhëzimet administrative të MASHT-it;

-Informimi i nevojshëm i Kuvendit Komunal për rezultatet, vështirësitë dhe rrjedhën e procesit edukativo arsimor në tërësi në komunën tonë.

-Monitorimi dhe vlerësimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i monitorimit është që të shtohet cilësia në mësimdhënie dhe mësimnxënie, të përmirësohet plani dhe programi si dhe të shtohet efikasiteti i punës së institucioneve edukativo-arsimore në komunën e Deçanit.

Gjatë vitit 2026-të planifikojmë të realizojmë vizita monitoruese të shpeshta në të gjitha institucionet shkollore, të jemi në kontakt të vazhdueshëm me udhëheqësin e shkollës, mësimdhënësit, nxënësit, shërbimin teknik dhe prindërit me qëllim të ofrimit të ndihmës për ngritje të efikasitetit dhe cilësisë së punës edukativo - arsimore dhe rritjes së të gjitha potencialeve për përparim të vazhdueshëm.

Pra, nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme, anketimeve, pyetësorëve, bashkëbisedimeve dhe shumë instrumenteve tjera do të realizohet mbikëqyrja për së afërmi e rrjedhës së punës në shkolla.

Në këtë drejtim për ta përmbushur këtë qëllim ne do të bashkëpunojmë edhe me Sektorin e Inspektimit të Arsimit Rajonal-Pejë (SIA).

Sektori i Arsimit duke u bazuar në strukturën e organizimit dhe funksionimit të DKA-se në bazë të udhëzimit administrativ të MASHT-it, punën e vet kryesisht do ta orientojë në: Në krijimin dhe mbikëqyrjen e kushteve normale për punë të institucioneve edukativo-arsimore në katër nivele:

**Niveli 0:** Arsimiti parashkollor moshë e fëmijëve prej (5 vjet).

**Niveli 1:** Arsimiti fillorë prej moshës 6 vjet.

**Niveli 2:** Arsimiti i mesëm i ulët prej moshës 12 vjet dhe

**Niveli 3:** Arsimiti i mesëm i lartë prej moshës 15 vjet.

Mbikëqyrjen e realizimit të plan-programeve globale mësimore dhe atyre konkrete të mësimdhënësve në institucionet edukativo-arsimore në të tri nivelet.

-Mbikëqyrjen dhe realizimin e plan-programeve vjetore të shkollave.

-Përcjelljen dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organeve udhëheqëse dhe profesionale të shkollave.

Përcjelljen dhe krijimin e kushteve normale për punë të nxënësve me nevoja të veçanta.

Mbështetjen dhe krijimin e kushteve për punë shtesë të nxënësve me talent të veçantë dhe avancimin e tyre.

Krijimin e kushteve të punës për stafin profesional të DKA-së, duke bërë aftësimin profesional të tyre përkrah zhvillimit të shoqërisë sonë dhe trendëve më bashkëkohore;

Zyrtarët Komunal Arsimor vazhdimisht do të monitorojnë dhe kontrollojnë punën në shkolla, do të hartojnë edhe raporte për funksionimin e institucioneve arsimore me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe shtimin e përgjegjësisë së të gjithëve në punë; Do të organizohen kurse të vazhdueshme në Qendrën për Ngritje Profesionale për zhvillimin profesional të mësimdhënësve me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të mësimdhënësve për punë efektive në klasë dhe për qasje bashkëkohore në trendët e reja arsimore globale.

### Buxheti i Drejtoratit për Arsim për vitin 2026

|        |                               |              |
|--------|-------------------------------|--------------|
| 1      | Pagat dhe Meditjet (Ad+AF+AM) | 5 047 740.51 |
| 2      | Mallra e Shërbime             | 237 364.00   |
| 3      | Shpenzime Komunale            | 40 000.00    |
| 4      | Te hyrat vetanake             | 10 000.00    |
| 5      | Shpenzimet Kapitale           | 100 000.00   |
| 6      |                               |              |
| TOTALI |                               | 5 435 104.51 |

### Buxheti i Arsimit për vitin 2026 sipas kategorive

Buxheti sipas kategorive:

- Granti Specifik i Arsimit
- Të Hyrat Vetanake
- Granti i Përgjithshëm për Arsim

Nivelet shkollore:

- Arsimi Parashkollor
- Arsimi Fillor
- Arsimi i Mesëm u Ultë
- Arsimi i Mesëm i Lartë

| Kodi i Programit | Përshkrimi                      | Stafi | Paga dhe Meditje | Mallëra dhe Shërbime | Shpenzi me Komunale | Investim e kapitale (rezerva) | Totali       |
|------------------|---------------------------------|-------|------------------|----------------------|---------------------|-------------------------------|--------------|
|                  | Arsim dhe Shkencë               | X     | 5 047 740.51     | 237 364              | 40 000              | 100 000                       | 5 435 104.51 |
|                  | Granti i Përgjithshëm për Arsim |       | 158 469.51       | 168 414              | 30 000              | 100 000                       | 456 883.51   |
|                  | Granti Specifik për Arsim       |       | 4 889 271.00     | 68 950               | 10 000              |                               | 4 968 221.00 |
|                  | Të Hyrat Vetanake               |       |                  | 10 000               |                     |                               | 10 000       |
|                  | Huamarrja                       |       |                  |                      |                     |                               |              |
|                  | Administrata e Arsimit          | x     | 66 566.91        | 15 000               |                     |                               | 91 566.91    |
|                  | Të hyrat vetanake               |       |                  | 10 000               |                     |                               |              |
|                  | Granti i Përgjithshëm për Arsim |       |                  |                      |                     |                               |              |

|          |                                 |   |              |         |        |         |              |
|----------|---------------------------------|---|--------------|---------|--------|---------|--------------|
|          | Granti Specifik për Arsim       |   |              |         |        |         |              |
|          | Arsimi Parashkollor             |   |              |         |        |         |              |
|          | Granti i Përgjithshëm për Arsim |   |              |         |        |         |              |
|          | Granti Specifik për Arsim       |   |              |         |        |         |              |
|          | Të Hyrat Vetanake               |   |              |         |        |         |              |
|          | Arsimi Fillor                   | x |              |         |        |         |              |
|          | Granti i Përgjithshëm për Arsim |   | 91 902.60    | 153 414 | 30 000 | 100 000 | 375 316.60   |
|          | Granti Specifik për Arsim       |   | 3 963 845.40 |         |        |         | 3 963 845.40 |
|          | Huamarrja                       |   |              |         |        |         |              |
|          | Arsimit i Mesëm                 | x |              |         |        |         |              |
|          | Granti i Përgjithshëm për Arsim |   |              |         |        |         |              |
|          | Granti Specifik për Arsim       |   | 925 425.60   | 68 950  | 10 000 |         | 1 004 375.60 |
|          | Të Hyrat Vetanake               |   |              |         |        |         |              |
| Gjithsej |                                 |   | 5 047 740.51 | 247 364 | 40 000 | 100 000 | 5 435 104.51 |

**Plani i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2025/2026**

| Plani i punës në Drejtorinë Komunale<br>Arsimit Për vitin shkollor 2025/2026                                                                                                                        | KOHA E REALIZIMIT |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | Imple<br>mentue<br>si |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|-----------------------|
|                                                                                                                                                                                                     | I                 | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |                       |
| Analiza e suksesit të nxënësve gjatë vitit shkollor 2025/2026 në fund të 2 periudhave dhe në fundin e vitit shkollor (Raport në Kuvend)                                                             | √                 |    |     | √  |   |    | √   |      |    |   |    | √   | DKA                   |
| Informatë mbi fillimin e vitit shkollor 2025/2026                                                                                                                                                   |                   |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA                   |
| Hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit të ri shkollor. Vizitë me kryetarin e komunes me qëllim të urimit të nxënësve dhe arsimtarëve                                                | √                 |    |     |    |   | √  |     |      | √  |   |    | √   | DKA & Kuvendi komunal |
| Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasave parafillor dhe fillor                                                                                                                              |                   |    |     |    |   | √  |     | √    |    |   |    |     | DKA & Shkollat        |
| Java e gjelbërimit për shkollat e komunës                                                                                                                                                           |                   |    |     | √  |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA shkollat komunale |
| Aktivizimi i Qendrës së Zhvillimit në Karrierë                                                                                                                                                      | √                 | √  |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA & Shkollat        |
| Trajnimet e vazhdueshme dhe të domosdoshme të stafit arsimor (drejtorëve, zv.drejtorëve, mësuesve dhe të tjerëve)                                                                                   | √                 | √  | √   | √  | √ | √  | √   | √    | √  | √ | √  | √   | DKA & Shkollat        |
| Formimi (aktivizimi) i komisioneve të punës në kuadër të DKA-së                                                                                                                                     | √                 | √  | √   | √  | √ |    | √   | √    | √  | √ | √  | √   | DKA & Shkollat        |
| Hartimi i Rregulloreve                                                                                                                                                                              | √                 | √  | √   |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA                   |
| Aktivizimi i Komisionit për Vlerësimin e Fëmijëve me nevoja të veçanta                                                                                                                              | √                 | √  | √   | √  | √ | √  | √   | √    | √  | √ | √  | √   | DKA                   |
| Vazhdimi i bashkëpunimit me lidhjet e krijuara me Drejtorin Komunal dhe shkollat të shteteve të ndryshme si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe arsimin në komunën e Deçanit |                   |    |     |    | √ | √  |     |      |    |   |    |     | DKA                   |
| Organizimi dhe bartja e nxënësve për garat në lëndë të ndryshme                                                                                                                                     |                   |    |     |    | √ | √  |     |      |    |   |    |     | DKA MASH T            |
| Organizimi i garave në nivel komune me nxënës të SHFMU, dhe të mesme të larta në drame, recitim, muzikë art, shkencë, etj                                                                           |                   | √  | √   | √  |   | √  | √   | √    |    |   |    |     | DKA                   |
| Bashkëpunimi me MASHTI-n-, Zyrën Rajonale të Inspeksionit në fushën e arsimit                                                                                                                       |                   |    |     |    |   |    | √   |      |    |   |    |     | DKA                   |
| Përgatitja e projekteve për rregullim të infrastrukturës shkollore, oborreve dhe këndeve të gjelbërta të shkollave                                                                                  |                   |    |     |    |   |    | √   |      |    |   |    |     | DKA                   |
| Organizimi dhe mbajtja e intervistës me kandidatët konkurrues                                                                                                                                       |                   |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA                   |
| Vlerësimi dhe përzgjedhja e personelit arsimor në bazë të konkursit të rregullt sipas UA                                                                                                            |                   |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA                   |
| Përgatitja e vendimeve për shkuarje në                                                                                                                                                              |                   |    |     |    |   |    | √   |      |    |   |    |     | DKA                   |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                         |   |   |   |   |  |   |   |   |   |   |   |   |   |              |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|---|---|---|--|---|---|---|---|---|---|---|---|--------------|
| pushim vjetor të punëtorëve arsimor                                                                                                                                                                                                                                                     |   |   |   |   |  |   |   |   |   |   |   |   |   |              |
| Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në SHML dhe IAAP                                                                                                                                                                                                             |   |   |   |   |  |   |   | √ |   |   |   |   |   | DKA MASH T   |
| Përcjellja e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollat e mesme nga konkursi plotësues                                                                                                                                                                                          |   |   |   |   |  |   |   | √ |   |   |   |   |   | DKA          |
| Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditarë pune, libra të amzave, libra të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor                                                                                                                                                       |   |   |   |   |  |   | √ | √ | √ |   |   |   |   | Shkoll ë DKA |
| Përcjellja, bashkëorganizimi i punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturantëve                                                                                                                                                                                         |   |   |   |   |  |   |   |   | √ |   |   |   |   | DKA shkolla  |
| Raporti 6 mujor i Drejtorisë për Arsim                                                                                                                                                                                                                                                  |   |   |   |   |  | √ |   |   |   |   |   |   | √ | DKA          |
| Plani i punës nga zyrtarët e DKA-së për vitin 2026                                                                                                                                                                                                                                      | √ |   |   |   |  |   |   |   |   |   |   |   |   | DKA          |
| Analiza e suksesit, përpunimi dhe nxjerrja e shënimeve statistikore për shkollat e KK-Deçan për gjysmëvjetorin e parë 2025/2026                                                                                                                                                         | √ |   |   |   |  |   |   |   |   |   |   |   |   |              |
| Vlerësimi i punëve të zyratëve të DKA-së                                                                                                                                                                                                                                                |   |   |   |   |  |   |   |   |   |   |   |   | √ |              |
| Takime me drejtorët e shkollave dhe zyrtarët e DKA-së, temat e takimeve: Zhvillimi i procesit edukativo arsimor, etj.<br>Mbikqyrja e realizimit të planprogrameve të punës të drejtorëve të shkollave dhe zyrtarëve të DKA-së për vitin shkollor 2025/2026<br>Raporti i punës tremujore | √ | √ | √ | √ |  | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | DKA          |

## Plani i punës për përgatitjen e lokaleve shkollore për vitin shkollor 2025/2026

| Plani i punës për përgatitjen e lokaleve shkollore për vitin shkollor 2025/2026                                                                                  | KOHA E REALIZIMIT              |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | Implementuesi                    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|----------------------------------|
|                                                                                                                                                                  | I                              | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |                                  |
| Përgatitja teknike e lokaleve shkollore: gëlqerosja, dezinfektimi, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i Inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri. |                                |    |     |    |   |    | √   |      | √  |   |    | √   | Skolla DKA                       |
| Realizimi i procedurave për përzgjedhjen e operatorit furnizues me lëndë djegëse: dru, etj.                                                                      |                                |    |     |    |   |    | √   | √    |    |   |    |     | DKA                              |
| Përzgjedhja e operatorit për furnizimin e shkollave me lëndën djegëse në koordinim me Zyren e Prokurimit                                                         |                                |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA                              |
| Furnizimi i shkollave me lëndën djegëse: dru, etj.                                                                                                               |                                |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA                              |
| Kontrollimi i sistemit të ngrohjeve nëpër shkolla.                                                                                                               |                                |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA                              |
| Riparimi i ujit të ujësjes dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë probleme me ujë të pijshëm                                                    |                                |    |     |    |   |    |     | √    | √  | √ |    |     | DKA & shkolla                    |
| Furnizimi i shkollave me mjete mësimore didaktike në salla të kabinete për lëndet: matematike fizike, kimi, biologji, etj                                        |                                |    |     |    |   |    |     | √    | √  | √ |    |     | DKA & shkolla                    |
| Furnizimi i shkollave me inventar shkolle: banka, karrige, tavolina tabela dhe dollapë për bibliotekat shkollore etj.                                            |                                |    |     |    |   |    | √   | √    | √  |   |    |     | DKA & Shkolla                    |
| Mirëmbajtja (rregullimi) e shkollave dhe oborreve shkollore                                                                                                      |                                |    |     |    | √ | √  | √   | √    | √  |   |    |     | DKA & shkolla                    |
| Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive                                                                                                                    |                                |    |     |    | √ | √  | √   | √    | √  |   |    |     | DKA & shkolla                    |
| Furnizimi dhe mbikëqyrja e furnizimit të nxënësve me tekste                                                                                                      |                                |    |     |    |   |    | √   | √    | √  |   |    |     | MASHTI, DKA                      |
| Furnizimi i shkollave me mjete higjienike dhe aparate për shuarjen e zjarrit                                                                                     | I përhershëm dhe sipas nevojës |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA & shkolla                    |
| Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave                                                                                                  | Sipas kërkesave                |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA & shkolla                    |
| Furnizimi i shkollave me karburante për gjeneratorët                                                                                                             | Sipas kërkesave                |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA & shkolla                    |
| Furnizimi i shkollave me materiale për zhvillimin e aktiviteteve të lira sipas prioriteteve të shkollave                                                         | Sipas kërkesave                |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA & shkolla                    |
| Planifikimi dhe realizimi (përkujdesja nga DKA) investimeve kapitale në shkollat tona                                                                            | Gjatë gjithë vitit             |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA, MASHTI, Komuna dhe të tjerë |
| Implementimi i pjesës që ka të bëjë me Planin Zhvillimor të DKA-së                                                                                               | Në vazhdimësi                  |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA.K. Komunal                   |

**Plani i punës që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2026/2026**

| Plani i punës që kanë të bëjnë me procesin edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2025/2026                                                                                           | KOHA E REALIZIMIT                          |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | Implementuesi                                          |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|--------------------------------------------------------|
|                                                                                                                                                                                       | I                                          | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |                                                        |
| Rregullimi i dokumentave për pronat shkollave sipas siperfaqes kadastrale                                                                                                             | E vazhdueshme                              |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA                                                    |
| Monitorimi i sistemit SMIA nga DKA-a                                                                                                                                                  | √                                          |    |     |    |   | √  |     |      | √  |   |    | √   | DKA                                                    |
| Organizimi i mësimi shtesë për maturantët                                                                                                                                             |                                            |    |     | √  | √ | √  |     |      |    |   |    | √   | DKA & Shkolla                                          |
| Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbërta shkollore                                                                                   |                                            |    |     | √  | √ | √  | √   | √    | √  |   |    |     | DKA                                                    |
| Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës në Qendrën për Ngritje Profesionale sipas Prioriteteve të Planit për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve të Komunës së Deçanit            |                                            |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA, MASHTI, OJQ të licencuara nga MASHTI për trajnime |
| Përcjellja e braktisjes së nxënësve, detyrë permanente                                                                                                                                |                                            |    |     | √  | √ | √  | √   | √    | √  | √ | √  | √   | DKA                                                    |
| Bashkëpunimi me OJQ në fushën e realizimit të drejtave të fëmijëve dhe sigurisë së nxënësve në shkollë detyrë e përhershme, kundër trafikimit, punës së fëmijëve në rrugë, drogës etj |                                            |    |     | √  | √ | √  | √   | √    | √  | √ | √  | √   | DKA                                                    |
| Analiza e punës edukativo-arsimor                                                                                                                                                     | √                                          |    |     |    |   | √  |     |      | √  |   |    | √   | DKA                                                    |
| Përcjellja e lëvizjes së personelit                                                                                                                                                   | I përhershëm, sipas nevojës                |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA                                                    |
| Shpallja e konkurseve për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas kërkesave të shkollave                                                                                          | Sipas nevojës                              |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA & Shkolla                                          |
| Plotësimi i vendeve të lira të punës                                                                                                                                                  | Sipas nevojës                              |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA                                                    |
| Vlerësimi i punës edukativo arsimor të shkollave nëpërmjet vizitave dhe bashkëpunimit me prindër                                                                                      |                                            |    |     | √  | √ | √  |     |      | √  | √ | √  | √   | DKA & shkolla                                          |
| Përgatitje profesionale e arsimtarëve, organizimi i trajnimeve në koordinim me MASHTI-n, KEC-in etj.                                                                                  |                                            |    |     |    | √ | √  |     |      | √  | √ | √  | √   | DKA MASHTI                                             |
| Përgatitjet për kremtimin e festave shtetërore                                                                                                                                        |                                            | √  |     |    |   | √  |     |      |    |   | √  |     | DKA                                                    |
| Organizimi i vizitave studimore me stafin e DKA-se jashtë vendit                                                                                                                      |                                            |    |     |    |   |    |     | √    |    |   |    |     | DKA                                                    |
| Përcjellja permanente e aktiviteteve mësimore e jashtëmësimore të nxënësve nëpër shkollë                                                                                              | E vazhdueshme                              |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA & Shkolla                                          |
| Shpallja e konkurseve për personelin udhëheqës - drejtorë të shkollave                                                                                                                | Sipas nevojës                              |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA                                                    |
| Takimin përmblyllës për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 me drejtorë, mësimdhënës dhe nxënës të dalluar                                                                         |                                            |    |     |    |   | √  |     |      |    |   |    |     | DKA & Shkolla                                          |
| Përcjellja e realizimit të mbrëmjeve të matura                                                                                                                                        |                                            |    |     |    | √ | √  |     |      |    |   |    |     | DKA & Shkolla                                          |
| Mbarimi i mësimi për maturantët                                                                                                                                                       | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHI      |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | MASHTI, DKA                                            |
| Riprovimet për nxënës të cilët nuk kanë treguar rezultate pozitive në disa lëndë mësimore                                                                                             | Sipas kalendarit dhe udhëzimeve nga MASHTI |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | Shkollat                                               |
| Provimi i maturës                                                                                                                                                                     | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI     |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | MASHTI, DKA                                            |
| Publikimi i rezultateve të provimit të matura                                                                                                                                         | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI     |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | MASHTI, DKA                                            |
| Shqyrtimi i ankesave të nxënësve                                                                                                                                                      | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI     |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | MASHTI, DKA                                            |
| Publikimi i rezultateve të ankesave                                                                                                                                                   | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI     |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | MASHTI, DKA                                            |
| Testi i arritshmërisë për klasat e IX-ta                                                                                                                                              | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI     |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | MASHTI, DKA                                            |

|                                                              |                                        |            |
|--------------------------------------------------------------|----------------------------------------|------------|
| Paraqitja e provimit për afatin e gushtit                    | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI | DKA        |
| Provimi i maturës - afati i dytë                             | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI | MASHTI,DKA |
| Publikimi i rezultateve të provimit të maturës, afati i dytë | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI | MASHTI,DKA |
| Shqyrtimi i ankesave të nxënësve                             | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI | MASHTI,DKA |
| Publikimi i rezultateve të ankesave                          | Sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI | MASHTI,DKA |

**Në vitin 2026 - pensionime dhe shpallje të konkurseve janë planifikuar si vijon:**

Mesimdhenës (12);

Edukatore: 1

Punëtor Teknik- Pastrues (2);

Drejtor shkollë (1).

Sekretar shkollë: 1

Asistentë për FNVA: 14

Pedagog: 1

Psikologë: 5

Këshilltar për karrierë: 1

Gjithësej: 11 pensionime për vitin kalendarik 2025

Sqarim: Nuk janë të përfshira largime më dëshirë, zëvendësimet e lehonisë dhe pushimet mjekësore.

**Aktiviteti dhe bashkëpunimi i DKA-s me Kryetarin e Komunës MASHT-in, drejtorët e drejtorive nga komunat tjera dhe me qytetarët**

|                                                                                        |                                |                |
|----------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|----------------|
| Bashkëpunimi i rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, në veçanti me DKRS         | I përhershëm dhe sipas nevojës | DKA            |
| Bashkëpunimi i rregullt me zyren inspeksionit të arsimit në nivel regjional            | Sipas nevojës                  | DKA            |
| Puna me palë-shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave                                        | E përditshme dhe sipas nevojës | DKA            |
| Bashkëpunimi i DKA-së me: Kryetarin e komunës, MASHTI, dhe të tjerët.                  | Të përhershme                  | DKA dhe MASHTI |
| Njoftimi dhe shfrytëzimi i ligjeve, UA, vendimeve dhe rregulloreve që dalin nga MASHTI | Sipas nevojës                  | DKA dhe MASHTI |
| Përcjellja e kërkesave, raporteve dhe informative nga aktiviteti i DKA-së në MASHTI    | Sipas nevojës                  | DKA dhe MASHTI |

|                                                                   |                                                             |                  |
|-------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|------------------|
| Pjesëmarrja e rregullt në Kolegjiun e Drejtorëve të Arsimit (APK) | Sipas ftesave                                               | DKA, MASHTI, APK |
| Takimet e rregullta me drejtorët e shkollave të komunës sonë      | Gjatë vitit (së paku 10 takime sipas muajve), sipas nevojës | DKA              |

**Bashkëpunimi i DKA-s me organet e sigurisë: Policinë, KFOR-in, OJQ-të dhe mediat**

| Bashkëpunimi i DKA-se me organet e sigurisë: Policinë, KFOR-in, OJQ-te, dhe mediat | KOHA E REALIZIMIT |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | Implementues |
|------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|--------------|
|                                                                                    | I                 | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |              |
| Pjesëmarrja në debatet me tema<br>dhe shoqërore organizuar nga OJQ-të              |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |              |
| Bashkëpunimi me Policinë<br>e Kosovës                                              |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |              |
| Bashkëpunimi me FSK-në                                                             |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |              |
| kontaktet me përfaqësues të KFOR-it<br>dhe të organizatave ndërkombëtare           |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |              |
| Bashkëpunimi me organizata të<br>ndryshme vendore e të huaja                       |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |              |
| Bashkëpunimi me donatorë vendorë<br>dhe të huaj                                    |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     |              |

**Bashkëpunimi me përfaqësuesit e K.Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane**

| Bashkëpunimi me përfaqësuesin e K.Komunal për implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me integrimet evropiane                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | KOHA E REALIZIMIT |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | Implementues |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----|-----|----|---|----|-----|------|----|---|----|-----|--------------|
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | I                 | II | III | IV | V | VI | VII | VIII | IX | X | XI | XII |              |
| Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe sigurisë në shkolla                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA          |
| Hartimi i programeve, planprogrameve dhe përgatitja e moduleve të trajnimit të mësimeve me theks të veçantë integrimi i gjinisë femërore si temë specifike                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA          |
| Identifikimi i shkollave që kanë nevojë për ndërtim dhe renovim, si dhe hartimi i listës prioritare<br><br>Përmirësimi i hapësirave ekzistuese shkollore (renovimi) dhe mbikëqyrja e punëve gjatë renovimeve<br><br>Identifikimi i nevojave për materiale dhe pajisje, si dhe përcaktimi i Prioriteteve të shkollave me nevoja me te theksuara.<br><br>Përgatitja e dratf rregullore për Kodin i mirësjelljes dhe masat disiplinore për dhe të larta |                   |    |     |    |   |    |     |      |    |   |    |     | DKA          |

Udhëheqësi i Sektorit të Arsimit

-----  
**Xhevat Bozhdaraj**